

L I G J
Nr.9578, datë 11.7.2006

PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË “MARRËVESHJEN E KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PONTILIT TË NAFTËS, GAZIT E NËNPRODUKTEVE TË TYRE NË ZONËN BREGDETARE TË PORTO-ROMANOS, DURRËS”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.9298, DATË 28.10.2004

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohen disa shtesa dhe ndryshime në “Marrëveshjen e koncesionit, të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”, ratifikuar me ligjin nr.9298, datë 28.10.2004, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4994, datë 25.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

SHTOJCË

“MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS BOT (NDËRTIM, SHFRYTËZIM, TRANSFERIM), PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PONTILIT TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NË ZONËN BREGDETARE TË PORTO-ROMANOS, DURRËS”, SI DHE GJASHTË ANEKSET PËRKATËSE

HYRJE

Sot më datë __/__/2006 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga “Organi Shtetëror i Autorizuar” OSHA dhe

Shoqërisë Koncesionare “Romano PORT” me seli në Durrës, regjistruar si person juridik me vendimin nr.30465, datë 28.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, i përfaqësuar nga z.Artan Dulaku dhe z.Veli Hoxha:

duke pasur parasysh që në marrëveshjen e nënshkruar me datë 8.9.2004 vërehen disa pasaktësi në disa nene të saj; interesin dhe rolin mbizotërues të shtetit në dhënien në koncesion, administrimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore e të zhvillimit të sektorëve të ekonomisë, palët bien dakord si më poshtë:

Në nenin 3 paragrafi 2 (faza e dytë) riformulohet:

1. Faza e dytë në programin e ndërtimit të pontilit me infrastrukturën përkatëse për përpunimin e tankerave që transportojnë në linjë detare naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre do të realizohen deri në 31.3.2007, me një investim total 8-10 milionë euro dhe kapacitet 15.000 tonë GLN dhe 20.000 tonë naftë. Programi i punimeve parashikohet në anekset 1,2,3,4,5 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje të cilat janë pjesë përbërëse e saj dhe përmban kryesisht:

- Punimet për ndërtimin e pontilit dhe infrastrukturës portuale (pontil, platformë objektet mbi platformë, pontile të mjeteve detare, rrugë, sheshe etj.).
- Punimet për thellimin e portit që përfshin kanalin hyrës.
- Instalimet e pajisjeve teknologjike, si: tubacione shkarkimi dhe transportimi në terminal, pajisje navigacionale, zjarrfikëse, sigurie, ndërlidhjeje, elektrike, hidraulike etj.
- Pajisjet dhe ndërtime për mbrojtjen e mjedisit.

- Punimet përkatëse për shërbimet portuale të përpunimit të tankerave deri në 20.000 tonë për naftën dhe 15.000 tonë për GLN dhe të sigurisë sipas aneksit 5, bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje.

2. Në marrëveshje midis dy palëve afatet e mësipërme mund të zgjaten deri në 6 muaj.

Në nenin 3 tek nëntitulli "Transferimi në shtet" shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

Ndërtimet e kryera në afërsi të detit janë pjesë e projektit të pontilit dhe ana funksionale e saj është për operimin, manovrimin dhe zyrat e administratës së portit, doganës, policisë doganore dhe policisë së shtetit. Këto ndërtime kalojnë në pronësi të shtetit, duke iu transferuar sipas kushteve të parashikuara në paragrafin e mësipërm, përveç ambienteve që do të përdoren nga koncesionari si ambiente për administratën e koncesionarit sipas skicës përkatëse, me sipërfaqe 400 m².

(Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimeve është 1.520 m²).

Neni 4 "Detyrimet e koncesionarit", shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

Me shpenzimet e veta, të bëjë sigurimin "All risk" të të gjithë objektit të koncesionit me kohëzgjatje për të gjithë periudhën e koncesionit.

Të mos lejojë përdorimin e portit nga subjekte të palicencuara, përveç rasteve kur kjo është kërkesë eksplicite e OSHA-së.

Në bashkëpunim me autoritetet portuale të marrë të gjitha masat e nevojshme, në respektim të kushteve të sigurisë teknike, për parandalimin e ndotjeve dhe të përdorimit të lëndëve kimike për pastrimin e ndotjeve në rastet e derdhjes së karburanteve në det. Për këtë koncesionari duhet t'u kërkojë anijeve që të kenë, si masë mbrojtëse, sasi të lëndës kimike të nevojshme.

Neni 4, në paragrafin 12 shtohet:

Tarifat dhe çmimet e aplikueshme për shërbimin do të rishikohen çdo vit. Tarifat e reja të rishikuara do të shpallen nga OSHA dhe koncesionari 30 ditë përpara datës së hyrjes së tyre në fuqi. Deri në atë moment do të vazhdojnë të aplikohen tarifat dhe çmimet e mëparshme.

Neni 4, pas paragrafit të fundit shtohet ky paragraf:

Menaxhimi i portit

Menaxhimi i pontilit të kryhet për dy vitet e para nga një kompani e huaj ose përfaqësues të saj me eksperiencë të ngjashme në menaxhime të tilla, për të cilat koncesionari do t'i japë OSHA-së argumentet e veta. Nëse OSHA-ja e shikon të arsyeshme, ky afat mund të shtyhet deri dhe në dy vjet të tjera.

Në nenin 4 nëntitulli "koncesionari ka të drejtë" riformulohet:

Palët janë të ndërgjegjshme se:

Pontili me infrastrukturën e tij është projektuar dhe do të funksionojë si një port shërbimesh të pavarura, i hapur për të gjithë operatorët e kualifikuar në industrinë e naftës e nënprodukteve të saj dhe do të sigurojë, për rrjedhojë, një bazë logjistike të një niveli shumë të lartë për të gjithë operatorët e licencuar në Shqipëri.

Koncesionari do të kryejë nëpërmjet pontilit vetëm veprimtarinë e ngarkim-shkarkimit të naftës, gazit të lëngshëm dhe nënprodukteve të saj dhe jo aktivitete të tjera tregtare. Anijet që do të futen dhe do të dalin nga ky pontil, do të paguajnë ato tarifa për kryerjen e shërbimeve nga koncesionari që janë të miratuara nga OSHA-ja.

Në nenin 5, pas paragrafit të fundit shtohen këta paragrafë me këtë përmbajtje:

1. Me kërkesë të koncesionarit, OSHA-ja do të përdorë të gjithë autoritetin dhe kompetencat e saj për të bërë të mundur marrjen nga koncesionari të të gjitha lejeve, autorizimeve të nevojshme për studimin, projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit, dhe të lejeve dhe të autorizimeve të nevojshme nga institucionet qendrore përkatëse dhe organet e pushtetit vendor, me qëllim arritjen (realizimin) e projektit të koncesionit.

2. Koncesionari nuk do konsiderohet përgjegjës për çfarëdolloj humbjeje, dëmtimi që mund t'u shkaktohet personave të tretë për shkak të ndotjes ekzistuese, që do të ketë shtrati i detit në zonën e koncesionit. Ndotja ekzistuese do të kuptohet dhe do të pranohet nga të dyja palët gjendja e trashëguar deri para fillimit të punimeve për zbatimin e projektit të koncesionit.

3. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje për çdo ndryshim në paketën e aksioneve të shoqërisë koncesionare do të merret miratimi i OSHA-së.

4. Asnjë nga aksionarët e shoqërisë koncesionare, që zotërojnë më shumë se 1% të aksioneve të saj, nuk do të krijojë maxhorancë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në paketën e aksioneve ose në atë masë apo mënyrë që mund të kenë kontrollin dhe vendimmarrjen, të shoqërive të tjera, që operojnë me depozitat e tyre në zonën e koncesionit të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.30, datë 28.1.2001 dhe vendimin nr.21, datë 19.10.2001 të KRRTRSH. Çdo ndryshim nga ky rregull do të bëhet vetëm me miratimin e OSHA-së. Shkelja e këtij detyrimi nga koncesionari i jep të drejtë OSHA-së të

rishikojë kushtet e marrëveshjes së koncesionit.

Në nenin 7, pas paragrafit të fundit, shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

OSHA mbikëqyr procedurat e hyrjes dhe daljes nga porti duke pasur të drejtë të vendosë, në rast se ka më shumë se një anije që kërkon të shkarkohet, radhën preferenciale të hyrjes.

OSHA, në zbatim të kërkesave të legjislacionit shqiptar, vendos kushtet e kriteret teknike që duhet të plotësojnë anijet që do të hyjnë në këtë port dhe gëzon të drejtën të përjashtojë ato anije që nuk plotësojnë kushtet e vendosura prej saj për kategorinë, llojin etj.

Neni 13 “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve” riformulohet:

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të dalin nga kjo marrëveshje e koncesionit, të cilat nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim nga përfaqësuesit e palëve (në kuptim të këtij neni, përfaqësuesi i shtetit shqiptar do të jetë i Autorizuari Ligjor i Shtetit (OSHA) dhe për koncesionarin do të jetë aksionari që zotëron shumicën e aksioneve, gjatë të dy takimeve të cilat do të zhvillohen brenda një periudhe kohe jo më gjatë se 60 ditë që nga dita e paraqitjes së kërkesës me shkrim nga njëra prej palëve) do të trajtohen e do të zgjidhen nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar (siç parashikohet në nenin 17 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995), në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, nga një ose më shumë arbitra të caktuar në përputhje me rregullat e sipërpërmendura. Arbitrat do të zbatojnë dhe do të marrin vendime, duke u bazuar në të drejtën franceze.

Vendi i arbitrazhit do të jetë Parisi. Gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Vendimi i dhënë nga arbitri do të jetë detyrues dhe përfundimtar për palët. Interpretimi i marrëveshjes do të bëhet në gjuhën shqipe.

Neni 14 “Sanksionet” riformulohet:

Në rast se për faj të koncesionarit, do të konstatohen nga OSHA-ja shkelje të afatit të zbatimit të projekteve, të përcaktuara në nenin 3 të marrëveshjes së koncesionit, koncesionari paguan penalitet në vlerën 0,05% në ditë të vlerës së investimit të përfunduar në çdo fazë.

Në qoftë se koncesionari kryen punime pa leje ndërtimi, i jepet gjobë 20 000 euro dhe OSHA-ja ka të drejtën e bllokimit të ndërtimit.

Koncesionari do të penalizohet në rast se:

- Shkel ose ndryshon projektin pa miratim të OSHA-së. Në këtë rast, përveç sanksioneve që parashikon ligji “Për urbanistikën”, ai i paguan OSHA-së penalitet në shumën 10 000 euro.

- Shkel afatin për dhënien e informacionit OSHA-së sipas përcaktimeve të nenit 15 të marrëveshjes. Në këtë rast koncesionari i paguan OSHA-së penalitet në shumën 1000 euro.

- Në qoftë se shkel të drejtën e barazisë për shërbim ndaj të tjerëve, i paguan OSHA-së penalitet në vlerën 5000 euro; penalitet i cili nuk lidhet me dëmin ndaj të tretëve prej koncesionarit për shkak të shkeljes së kësaj barazie.

Neni 15 “Bashkëpunimi” riformulohet:

OSHA dhe koncesionari angazhohen reciprokisht për të bashkëpunuar dhe kooperuar midis tyre, me qëllim që të garantohet realizimi optimal i projektit. Për këtë çdo njoftim ose komunikim i kërkuar ose i lejuar sipas kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe do t’i dorëzohet palës personalisht, me faks ose me shërbimin e postës. Çdo njoftim i tillë do të konsiderohet se është dhënë në ditën në të cilën ajo është marrë ose në rast se dita nuk është ditë-pune në ditën pasardhëse.

Koncesionari, sipas procedurave të mësipërme të njoftimit, detyrohet të informojë OSHA-në për realizimin e grafikut të punimeve dhe realizimin e investimeve për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit në zonën koncesionare. Ky informacion do t’i dërgohet OSHA-së në çdo 60 ditë-pune.

Korrespondenca midis palëve do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Tel..... Fax.....	Shoqëria “Romano-Port” sh.a. Rruga “Perlat Rexhepi”, pallati nr.9, Ap.4/4, Tiranë Tel: 04 271 636 Fax: 04 271 632
---	--

Çdo ndryshim i adresës do të konsiderohet i vlefshëm pasi ai t’i jetë komunikuar me shkrim palës tjetër nga pala e interesuar.

Shtojca e marrëveshjes, si dhe anekset 1,1/1.2.3.4.5 bashkëlidhur hyjnë në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe miratim nga Këshilli i Ministrave.

ANEKS 1

NDËRTIMI I PONTILIT TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NË ZONËN

BREGDETARE TË PORTO-ROMANOS

Ndërtimi i infrastrukturës portuale së bashku me instalimet teknologjike, të sigurisë, pajisjeve mjeteve dhe objekteve të shërbimit për përpunimin e tankerave të karburanteve e të nënprodukteve të tyre dhe të GLN, me dy faza:

a.1 Në fazën e parë për përpunimin e tankerave të karburanteve dhe nënprodukteve të tyre 5 deri në 7000 TDW dhe të tankereve të GLN deri në 3000 TDW. Periudha maksimale e kësaj faze do të jetë deri në 24 muaj.

1. Proceset e ndërtimit në këtë fazë, mbështetur në kryerjen e projektidesë dhe projektit të detajuar të alternativës së pontilit të përzgjedhur, mbi bazën e studimeve të detajuara të hidrometrologjisë në shkallën 1:1000, të studimit sizmik, të studimit gjeologo-inxhinierik, të modelimit hidraulik dhe të vizatimeve të projektit të detajuar për shkallën 1:500 për punimet në përgjithësi dhe ato detare deri në shkallën 1:50, do të përfshijnë:

1.1 Punimet e piketimit.

1.2 Punimet e zbatimit për ndërtimin e infrastrukturës portuale pontilin kryesor (dallgëthyesin për GLN), platforma dhe objektet mbi platformë, pontile të mjeteve detare, rrugë, sheshe dhe objekte të tjera të nevojshme.

1.3 Punimet për thellimin e portit, përfshirë kanalin e hyrjes së anijeve dhe akuariumet e domosdoshme, kryesisht për përpunimin e tankerave të GLN ose dhe të karburanteve apo nënprodukteve të tyre.

1.4 Ndërtime civile për menaxhimin, administrimin dhe shërbimeve të tjera në port.

2. Instalimet e pajisjeve teknologjike

2.1 Tubacionet, së bashku me pajisjet e tyre për shkarkimin e transportimin e naftës dhe të GLN dhe të nënprodukteve të tyre deri në kolektorin qendror, mbështetur në përllogaritje, në lidhje me:

-Gjatësinë e tubacioneve,

-Diametri i brendshëm i llogaritur (Diametri i jashtëm, spesori, diametri i brendshëm dhe pesha për 1 ml tub me ujë),

-Distanca midis mbështetjeve,

-Distanca e faqeve të jashtme të tubave.

2.2 Pajisjet, sistemimet navigacionale dhe ndërlidhja;

2.3 Pajisjet dhe sistemet e mbrojtjes ndaj zjarrit;

-Instalimi i dy sistemeve qendrore zjarrfikëse;

2.4 Pajisjet, mjetet dhe sistemet e sigurisë;

2.5 Impianti dhe pajisjet për sigurimin e energjisë elektrike (linjat e ndriçimit dhe të furnizimit me energji elektrike);

2.6 Impianti dhe pajisjet për furnizimin me ujë të pijshëm;

2.7 Impianti dhe linjat për furnizimin me karburant;

2.8 Pajisjet e sigurisë së mbrojtjes së mjedisit;

2.9 Mjete detare të shërbimit portual.

ANEKSI 1/1

a.2 Në fazën e dytë zgjerimi i infrastrukturës portuale për rritje të kapacitetit të përpunimit të tankerave, të karburanteve dhe të nënprodukteve të tyre deri në 15 000 TDW, në funksion të kërkesave të tregut pas 7 deri në 10 vjet.

- Pontil, 800 ml me vlerë 7 milionë \$.

- Platformë për anije 15 TDW me vlerë 2.2 milionë \$.

- Tubacionet për karburantet dhe nënprodukteve të tyre me vlerë 2.5 milionë \$.

Gjithsej, vlera e ndërtimit të objektit në fazën e dytë do të jetë 11.78 milionë \$ dhe do të përfundojë deri më 31.3.2007.

ANEKSI 2

SHFRYTËZIMI I PONTILIT TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE, NË ZONËN BREGDETARE TË PORTO-ROMANOS

Kryerja e shërbimit të përpunimit të tankerave të karburanteve e nënprodukteve të tyre dhe të GLN nëpërmjet shfrytëzimit të infrastrukturës portuale, instalimeve bregdetare, pajisjeve, mjeteve dhe objekteve

të shërbimit për të gjithë periudhën e koncesionit, konform rregullave dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare.

1. Funksionimi i terminalit
 - 1.1 Administrimi i pontilit (personeli teknik i drejtimit të aktivitetit në terminale);
 - 1.2 Shërbimi i rimorkimit të tankerave (mjete portuale);
 - 1.3 Pilotimi;
 - 1.4 Onmerxhimi;
 - 1.5 Pastrimi;
 - 1.6 Furnizimi me karburant;
 - 1.7 Furnizimi me ujë;
 - 1.8 Furnizimi teknik dhe i ushqimit etj;
 - 1.9 Agjencitë detare;
 - 1.10 Agjencitë doganore.
2. Bashkërendimi me autoritetet shtetërore
 - 2.1 Kapitenerinë e pontilit;
 - 2.2 Policinë kufitare;
 - 2.3 Doganën;
 - 2.4 Qendrën sanitare;
 - 2.5 Qendrën e sigurisë;
 - 2.6 Qendrën e mbrojtjes nga zjarri;
 - 2.7 Qendrën e mbrojtjes së mjedisit;
 - 2.8 Shërbimin e kontrollit të peshëmatjes dhe laboratorit të cilësisë së karburanteve, GLN dhe të nënprodukteve të tyre.

ANEKSI 3

MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS, PAJISJEVE DHE INSTALIMEVE TË PONTILIT TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NË ZONËN BREGDETARE TË PORTO-ROMANOS

Mirëmbajtja do të bëhet konform normave dhe standardeve ndërkombëtare për amortizimin e infrastrukturës së objekteve detare dhe instalimeve, pajisjeve dhe mjeteve të shërbimit detar në pronësi të koncesionarit.

1. Infrastrukturës portuale;
 - 1.1 Kanalin e hyrjes;
 - 1.2 Pontilim;
 - 1.3 Platformat dhe objektet mbi platformë;
 - 1.4 Pontilet e mjeteve detare;
 - 1.5 Rrugë, sheshe dhe ndërtime civile.
2. Instalimet, mjetet dhe pajisjet teknologjike;
 - 2.1 Tubacionet e shkarkimit;
 - 2.2 Pajisjet e tubacioneve të shkarkimit;
 - 2.3 Pajisjet navigacionale;
 - 2.4 Pajisjet zjarrfikëse;
 - 2.5 Pajisjet e sigurisë;
 - 2.6 Pajisjet e ndërlidhjes;
 - 2.7 Pajisjet elektrike;
 - 2.8 Pajisjet hidraulike;
 - 2.9 Pajisjet e mjedisit;
 - 2.10 Pajisjet meteorologjike;
 - 2.11 Mjetet detare të shërbimeve portuale.

ANEKSI 4

PËRSHKRIMI I TARIFAVE TË AKTIVITETEVE PËR SHFRYTËZIMIN E PONTILIT TË NAFTËS, GAZIT DHE TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE NË ZONËN BREGDETARE TË PORTO-ROMANOS

1. Tarifat e aktivitetit të ngarkim-shkarkimit të detajuar për tankerat sipas kapaciteteve për naftën,

gazin dhe nënproduktet e tyre.

2.Tarifat e shërbimeve të tjera portuale, përfshirë:

2.1 Pilotimi;

2.2 Onmerxhimi;

2.3 Pastrimi;

2.4 Furnizimi me karburant;

2.5 Furnizimi me ujë;

2.6 Furnizimi teknik dhe i ushqimit etj.;

2.7 Shërbimi i kontrollit të peshëmatjes dhe laborator i cilësisë së karburanteve; GLN dhe nënprodukteve të tyre.

ANEKSI 5

TRANSFERIM NË SHTET I PONTILIT TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NË ZONËN BREGDETARE TË PORTO-ROMANOS

1.Infrastruktura portuale;

1.6 Kanalin hyrës;

1.7 Pontilin;

1.8 Platformat dhe objektet mbi platformë;

1.9 Pontilet e mjetet detare;

1.10 Rrugë, sheshe dhe ndërtime civile.

2.Instalimet, mjetet dhe pajisjet teknologjike

2.10 Tubacionet e shkarkimit;

2.11 Pajisjet e tubacioneve të shkarkimit;

2.12 Pajisjet navigacionale;

2.13 Pajisjet zjarrfikëse;

2.14 Pajisjet e sigurisë;

2.15 Pajisjet e ndërlidhjes;

2.16 Pajisjet elektrike;


2.17 Pajisjet hidraulike;






2.18 Pajisjet e mjedisit;

2.19 Pajisjet metereologjike;

2.12 Mjetet detare të shërbimeve portuale.

PANJIA E PERGJITISHIME E FORTILIT NE PORTO-ROMAN, DURRES






- LEGEND
- 1. FLOOR
 - 2. ROOF
 - 3. WALL
 - 4. DOOR
 - 5. WINDOW
 - 6. STAIR
 - 7. HALL
 - 8. KITCHEN
 - 9. BATH
 - 10. BED
 - 11. LIVING
 - 12. DINING
 - 13. PORCH
 - 14. TERRACE
 - 15. GARAGE
 - 16. DRIVE
 - 17. WALK
 - 18. FENCE
 - 19. GROUND
 - 20. PLANT
 - 21. FURNITURE
 - 22. EQUIPMENT
 - 23. UTENSIL
 - 24. CLOTHES
 - 25. BOOKS
 - 26. TOYS
 - 27. SPORTS
 - 28. MUSIC
 - 29. ARTS
 - 30. GARDEN
 - 31. LAWN
 - 32. DRIVEWAY
 - 33. PORCH
 - 34. TERRACE
 - 35. GARAGE
 - 36. DRIVE
 - 37. WALK
 - 38. FENCE
 - 39. GROUND
 - 40. PLANT
 - 41. FURNITURE
 - 42. EQUIPMENT
 - 43. UTENSIL
 - 44. CLOTHES
 - 45. BOOKS
 - 46. TOYS
 - 47. SPORTS
 - 48. MUSIC
 - 49. ARTS
 - 50. GARDEN
 - 51. LAWN
 - 52. DRIVEWAY
 - 53. PORCH
 - 54. TERRACE
 - 55. GARAGE
 - 56. DRIVE
 - 57. WALK
 - 58. FENCE
 - 59. GROUND
 - 60. PLANT
 - 61. FURNITURE
 - 62. EQUIPMENT
 - 63. UTENSIL
 - 64. CLOTHES
 - 65. BOOKS
 - 66. TOYS
 - 67. SPORTS
 - 68. MUSIC
 - 69. ARTS
 - 70. GARDEN
 - 71. LAWN
 - 72. DRIVEWAY
 - 73. PORCH
 - 74. TERRACE
 - 75. GARAGE
 - 76. DRIVE
 - 77. WALK
 - 78. FENCE
 - 79. GROUND
 - 80. PLANT
 - 81. FURNITURE
 - 82. EQUIPMENT
 - 83. UTENSIL
 - 84. CLOTHES
 - 85. BOOKS
 - 86. TOYS
 - 87. SPORTS
 - 88. MUSIC
 - 89. ARTS
 - 90. GARDEN
 - 91. LAWN
 - 92. DRIVEWAY
 - 93. PORCH
 - 94. TERRACE
 - 95. GARAGE
 - 96. DRIVE
 - 97. WALK
 - 98. FENCE
 - 99. GROUND
 - 100. PLANT

REPUBLICA E SHQI
ROMANO-POI
DURRES-ALBA

ROMANO POI SHQ
LUG. AND JR. TERRIT. ROMANO POI
PRELIMINARY DESIGN
PLANS, ELEVATIONS AND SECTION

NOTES
1. ALL DIMENSIONS ARE IN METERS
2. ALL WALLS ARE 20 CM THICK
3. ALL FLOORS ARE 10 CM THICK
4. ALL ROOFS ARE 15 CM THICK



SCALE 1:100